

MONOTEIZMI DHE EVOLUCIONI

Marrë nga www.salafimanhaj.com

Shumë autorë afro-centrikë, orientalistë dhe antropologë pohojnë se monoteizmi ishte një shpikje që filloi në Egjiptin e lashtë nga dinastia e 18 e Faraonit Akhenaten/Amenhotepit të katërt, diku në shekullin 14 p.e.r.¹ Për çudi, një supozim i tillë vjen nga qarqet akademike që gëzojnë “respekt” dhe nga profesorët perëndimorë, që shpresojnë se njerëzit do t’i pranojnë verbazi “dëshmitë” e tyre, ndonëse asnjëri prej tyre nuk ishte dëshmitar i ngjarjes në fjalë. Për shembull, një supozim të tillë e hasim në librin e Julian Baldick “Black God - The Afroasiatic Roots of the Jewish, Christian and Muslim” (Zoti i zi - Rrënjët Afroaziatike të çifutëve, të të krishterëve dhe të muslimanëve) (Londër: I.B. Tauris, 1997).

Duke qenë nën ndikimin e teorisë së Darvinit, shumë historianë, sociologë dhe antropologë e marrin si të vërtetë pretendimin se religjioni te njerëzimi ka filluar me adhurimin e forcave natyrore, për shkak të mahnitjes së tyre me efektet shkatërruese që ato kishin në mjedisin e tyre dhe në natyrën. Në këtë mënyrë, bubullima, vetëtima, tërmetet, shpërthimi i vullkaneve konsideroheshin si qenie mbinatyrore. Si rezultat i këtij besimi, njerëzit iu rrekën gjetjes së mënyrave për t’i kënaqur dhe qetësuar këto qenie nëpërmjet ceremonive, ritualeve, faljeve dhe sakrificave të ndryshme. Autoktonët e Amerikës veriore, që besojnë në shpirta të lumenjve dhe të pyjeve, merren si shembull tipik i etapës së hershme në evolucionin e religjionit, që njihet si animizëm. Si rrjedhojë, shfaqet diateza e cila pohon se forcat mbinatyrore u reduktuan në dy zota kryesorë: zakonisht, në zotin e së mirës dhe zotin e së keqes. Sipas evolucionistëve, shembull i kësaj etape është religjioni i zoroastrianëve të Persisë. Para ardhjes në skenë të “reformuesit” persian Zaratustra², mendohet që persianët të kenë besuar në shpirta të natyrës, zota të fiseve dhe familjeve. Sipas dëshmive të mbledhura dhe të interpretuara nga antropologët, gjatë kohës së zoroastrianëve, zotat e fiseve u reduktuan në dy: *Ahura Mazda*, që kishte krijuar të mirën, dhe *Angora Mazda* si krijues i së ligës.

Me kalimin e fiseve në kombe, zotat fisnorë ia lëshuan vendin zotit kombëtar, dhe kështu, me sa duket, lind edhe monoteizmi. Sipas kësaj pikëpamjeje, të cilën e mbështesin shumica e autorëve afro-centrikë, e shkencëtarëve socialë, e orientalistëve dhe e antropologëve, monoteizmi nuk ka origjinë hyjnore. Këta pohojnë se monoteizmi

¹ Megjithatë, ky faraon më vonë e shpall veten e tij zot në tokë!

² Në greqisht, Zoroaster.

ishte thjesht një produkt i evolucionit të fazës së hershme të besëtytnive njerëzore, që vinin si pasojë e mungesës së njohurive shkencore.³

Dijetari i shquar i hadithit, Shejh Nasirudin el-Albani (*rahimehullah*)⁴, ka thënë:

“Është e pakontestueshme në Islam dhe në Sheriat se njerëzimi në fillim përbënte një bashkësi të vetme që ishin në teuhid [monoteizëm] të vërtetë e pastaj shirku gradualisht kishte depërtuar tek ata. Dëshmi për këtë është fjala e Allahut:

“Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu u dërgoi profetët me lajme të mira dhe paralajmërime.” (Kur’an, 2:113)

Ibn Abasi⁵, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë:

“Mes Profetit Nuh (Noa) dhe Ademit, paqja qoftë mbi të dy, ishin dhjetë gjenerata dhe të gjitha ishin në Sheriatin e drejtë, por, më pas, u përçanë. Kështu, Allahu dërgoi Profetë me lajme të mira dhe me paralajmërime për popujt e tyre.”

Më tej, Shejh Albani argumenton se dëshmitë e përmendura më lart (ajeti kuranor dhe hadithi autentik) hedhin poshtë pretendimet e filozofëve dhe të ateistëve të cilët thonë se bazë e natyrës njerëzore ishte shirku⁶, kurse teuhidi evoluoi në njeriun! Ajeti parapritës dhe hadithi autentik vijues hedhin poshtë këtë pohim.

Profeti Muhamed, salallahu alejhi ue selem, ka thënë:

“Allahu ka thënë: “Të gjithë robërit e mi i kam krijuar në fe të vërtetë (në teuhid e jo në shirk) e më pas shejtanët u erdhën atyre dhe i devijuan nga feja e vërtetë.

³ Dr. Ebu Aminah Bilal Philips “Fundamentals of Tawheed- Islamic Monotheism” (Bazat e Teuhidit-Monoteizmit Islam) (International Islamic Publishing House) fq., 183-190.

⁴ U lind në Shqipëri, por u rrit në Siri, ku u bë një ndër dijetarët më të dalluar islamikë. Shquhet si dijetari më i madh i shekullit në lëmin e hadithit dhe në përgjithësi si ripërtëritës i fesë Islame. Një kohë ishte edhe profesor në Universitetin Islamik të Medinës, bibliotekës së të cilit ia dedikoi një numër të madh librash. Ka bërë hulumtime referuese në hadith, siç janë: *Silsileh el-Hadith as-Sahihah* dhe *ed-Daifeh*. Ai është, po ashtu, autor i *Tehdhir es-Saxhid*, *et-Tevesul*, *Fikh ul-Vaki’i*, etj.

⁵ Abdullah ibn Abas (vdiq në vitin 68 pas Hixhretit/687 të erës së re). Ai ishte kushëriri i afërm i Profetit Muhamed, dhe një nga dijetarët më të spikatur të Kur’anit në mesin e shokëve të Profetit. Ishte i njohur si “*turxhuman ul-Kur’an*” (komentues i Kur’anit), jurist dhe dijetar i hadithit. Shpjegimet e tij të Kur’anit janë bazë e të gjitha shpjegimeve tjera të Kur’anit. Mirëpo, shumë komente që i vishen atij nuk janë autentike. I ashtuquajtur “Komentimi i Ibn Abasit”, i përpiluar nga Ebu Tahir Muhamed ibn Ja’kub el-Fejruzabadi, në realitet, nuk është nga Ibni Abasi.

⁶ Shirku është formë e adhurimit drejtuar të tjerëve krahas Allahut, i cili në vete ngërthen adhurimin e idhujve, të të shenjtëve, besëtytni të ndryshme, siç janë: leximi i shuplakës së dorës, leximi i fletëve të çajit, shikimi në rruzullin e kristaltë, magjitë, parashikimi i së ardhmes, pretendimi për njohjen e së padukshmes në sferën e ekzistencës, etj.

Ata ua ndaluan njerëzve atë që Unë ua kisha lejuar dhe i urdhëruan që Mua të më shoqërojnë ortak në adhurim, për çka nuk kam zbritur asnjë argument.”⁷

Po ashtu, Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë:

“Çdo fëmijë lind në *Fitreh* (animi natyror ndaj adhurimit të një zoti - sh.p.), por prindërit e tyre, më pas, e bëjnë çifut, të krishterë ose zjarrputist”.⁸

Më tej, argumenton Shejh Albani:

“Pas këtij shpjegimi të qartë, është me rëndësi për muslimanët ta dinë se si është përhapur shirku në mesin e tyre, pasi që ata fillimisht ishin *muvehidiin* (ata që e njësojnë Allahun me adhurim - sh.p.). Sa i përket fjalës së Allahut të Lartësuar, ku përmendet ngjarja e Nuhit:

“... dhe thanë: ‘Mos i lini kursesi zotat tuaj! Mos e lini kursesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën, as Nesrin!’” (Kur’an, 71:23)

shumë transmetime autentike nga selefët (brezat e parë të muslimanëve të devotshëm - sh.p.) tregojnë se këto pesë perëndi ishin adhurues të drejtë. Pas vdekjes së tyre, shejtani (satana) i pëshpëriti popullit të tyre që të uleshin tek varret e atyre njerëzve dhe t’i përkujtonin ata. Pastaj, shejtani iu paraqit në formë të njeriut brezit të ardhshëm dhe iu tha të bënin statuja dhe idhuj prej atyre njerëzve. Brezat e mëvonshëm, shejtani i urdhëroi t’i adhuronin këta idhuj duke iu thënë se kështu kishin vepruar edhe të parët dhe gjyshërit e tyre. Këtë ngjarje e shënon Ibn Xherir et-Taberiu dhe të tjerët. Në *Ed-Durr el-Mendhur* (6/269), Abdullah bin Humejd transmeton nga Ebu Mutaher, i cili ka thënë se Jezid ibnul Muhallab ishte përmendur te Ebu Xhafer el-Bekir (vdiq në vitin 11 pas Hixhretit), i cili më pas kishte thënë: “U vra në vendin ku për herë të parë ishte adhuruar dikush tjetër përveç Allahut.” Pastaj përmendi *Veddin* dhe tha: “*Veddi* ishte musliman, njeri i dashur tek populli i tij. Kur ai vdiq, njerëzit filluan të mblihdeshin rreth varrit të tij që gjendej në tokën e Babilit (Babilonisë), duke qarë e vajtuar. Ebu Xhaferi thotë se më vonë idhujt u quajtën *Vedd*.”⁹

Dëshmitë që flasin se koncepti monoteist, besimi në Një Zot i njerëzimit, kishte degjeneruar në idhujtari, adhurim të njerëzve, të të shenjtëve dhe të perëndive tjera janë të shumta. Feja Islame argumenton se qeniet njerëzore fillimisht adhuronin vetëm Një Zot, e më pas devijuan në shumë forma të politeizmit sikurse u përmendën më lart. Koncepti Islam thotë se Zoti kishte dërguar Pejgamberë për të gjitha fiset dhe popujt në

⁷ *Hadithi Kuds* është shpallje hyjnore që vjen drejtpërdrejt prej Allahut tek Muhamedi, salallahu alejhi ue selem. Këtë hadith e shënojnë Muslimi dhe Ahmedi nga Ijeh ibn Himar el-Muxhashi (radiAllahu anhu).

⁸ Adhurues i zjarrit. Arabisht: *mexhus*. Anglisht: *zoroastrian*.

⁹ Shejh Albani në *Tehdhir es-Saxhid min Itikadhil Kubur il-Mesxhid*, fq.101-106.

faqe të dheut, në mënyrë që t'i udhëzonte dhe t'i kthente ata përsëri në rrugën e monoteizmit.

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”” (Kur’an, 16:36).

Dijetari Islam Ibn ul-Ethiri ka thënë:

“Fitreh është predispozitë e natyrshme me të cilën lind çdo qenie njerëzore, predispozitë për fenë e vërtetë. Po të lihej njeriu ashtu, ai do të vazhdonte të mbetej në të. Megjithatë, devijimi prej natyrshmërisë së tyre vjen si shkak i dobësive njerëzore dhe pasimit të verbët të të tjerëve.”¹⁰

Më tej, dëshmitë tregojnë se në mesin e të gjitha fiseve të ashtuquajtura primitive që janë zbuluar deri më sot, ishte i pranishëm besimi në Një Zot. Majat e Amerikës qendrore besonin në Një Zot që kishte krijuar çdo gjë, të cilin e quanin *Itzamna*¹¹. Populli Mende i Sierra Leones në Afrikën perëndimore, besojnë në Një Zot i cili ka krijuar universin dhe shpirtrat, të cilin e quajnë *Ngevo*¹². Në Babiloninë e lashtë, perëndia *Merduk*¹³, perëndia kryesore e qytetit, shihej si Zoti më i Lartë. Në hinduizëm, *Brahman* është Një Zot i papërcaktuar e absolut, që nuk ka as fillim e as fund.¹⁴ Në religjionin Joruba, që numëron mbi 10 milionë ithtarë në Afrikën perëndimore (kryesisht në Nigeri), Zoti është Një dhe më i Larti, *Olorius/Olodumare* (Zoti i qiejve). Por, religjioni i sotëm i Jorubës karakterizohet me një mori ritesh të adhurimit të *Orisha-s*, që e shpijnë këtë religjion më afër politeizmit.

Stephen Langdon nga Oxford qe ndër shkencëtarët e parë perëndimorë që vërtetoi faktin se monoteizmi kishte degjeneruar në politeizëm të skajshëm. Langdon këtë pikëpamje e mbështet në faktin se sumerët ishin civilizimi më i vjetër historik, dhe shton:

“Opinionimi im është se historia e civilizimit më të vjetër të njeriut është një rënie rapide prej monoteizmit në politeizëm të skajshëm dhe në një besim në shpirtra. Kjo, në të vërtetë, është historia e rënies së njeriut.”¹⁵

¹⁰ *En-Nihaje* (3/457).

¹¹ John Hinnels “Dictionary of Religions” (Fjalori i religjioneve) (Penguin Books:1984), fq. 93.

¹² *ibid*, fq. 210.

¹³ *ibid*, fq.204.

¹⁴ *ibid*, fq. 68.

¹⁵ Stephen H. Langdon “Mythology of all Races” (Mitologjia e të gjitha racave) në “Semitic Mythology Journal” (Buletini i mitologjisë semitike) (Vëll.5, Archaeological Institute of America:1931 [Instituti arkeologjik i Amerikës]), fq. xviii/fq.18.

Edward McCrady, studiues i religjioneve Indiane, thotë se, madje, edhe *Rig Veda* (Libri 1, fq.164) tregon se perënditë e hershme shiheshin thjesht si manifestime të ndryshme të Një Qenieje të Vetme Hyjnore. Ai më tej jep këtë koment:

“Atë e quajnë *Indra, Mithra, Varuna, Agni* - të gjitha këto janë emërtime të ndryshme që tregojnë Një Zot të Urtë.”¹⁶

Historianët kinezë shpeshherë periudhën e tyre të lashtë e klasifikojnë në tri periudha të ndara: e para, primitive e lashtë; e dyta, e lashtë e mesme; e treta, e lashtë e afërme. Periudha e parë fillon përafërsisht prej shekullit 21 p.e.r. deri në shekullin 12 p.e.r. Sipas Ron Williams, i cili zotëron mirë leximin kinez, secila prej këtyre periudhave karakterizohet me tipare të veçanta religjioze. Periudha e parë ishte qartë monoteiste. Williams, më tej, thotë:

“Në këtë periudhë të historisë kineze, Zoti, Sunduesi Suprem, ishte Një dhe i pandashëm, që nuk u nënshtrohej ndryshimeve. Ky Zot nuk kishte rival dhe sundonte i vetëm, në mënyrë absolute, si lart në qiell, ashtu dhe poshtë në tokë. Ai bënte çfarëdo që dëshironte. Asnjë fuqi nuk mund ta pengonte dhe dëshira e Tij gjithherë ishte e drejtë.”¹⁷

Në një nga seritë e buletinit “Epokat e mëdha të njeriut”, një vëllim i veçantë i përkushtohet Kinës së lashtë nga autori Edward H. Schafer, i cili vëren me sa vijon:

“Njëra ndër perënditë më të vjetra dhe më të mëdha ishte Zoti Qiell, *Ti'en*. Në periudhën më të hershme, *Ti'en* konsiderohej si Mbret i madh në qiell, më madhështor se ndonjë në tokë. Më vonë, *Ti'en* shihej si gjenerator i papërcaktuar, burim i energjisë që ngjallte botën.”¹⁸

Një punim tjetër me vlerë të madhe, që shtjellon monoteizmin e hershëm të “njerëzve primitivë”, ishte ai i Wilhelm Schmidt. Ndonëse në gjermanisht është një punim voluminoz, në gjuhën angleze është botuar i përkthyer si përmbledhje në një vëllim në vitin 1930. Schmidt, në studimet e tij, kishte zbuluar se kulturat primitive, në fazat më të hershme të niveleve kulturore, kishin pasur koncepte të qarta rreth Zotit. Ai më tej thekson se, me progresin prej gjahtarëve të thjeshtë në grumbullues të ushqimeve, prej deponuesve të ushqimit në kultivues të ushqimit, si nomadë baritorë në shfrytëzues të bagëtive e deri në kultivues të ushqimit që kishin arat e tyre, e duke u ngritur deri në shkallën e komuniteteve gjysmë-urbane, një gjë që bie në sy është besimi i thjeshtë në një

¹⁶ Edward McCrady “Genesis and Pagan Cosmologies” (Gjeneza dhe kozmologjitë pagane), [Përkth. Vict.Institute; vëll.72 (1940), fq. 55].

¹⁷ Ron Williams “Early Chinese Monotheism” (Monoteizmi i hershëm kinezë), punim diplome i prezantuar para *Kelvin Institute* (Toronto, 1938).

¹⁸ Edward H. Schafer “Ancient China” (Kina e lashtë) në “The Great Ages of Man” (Epokat e mëdha të njeriut) (New York: Time Life, 1967) fq.58.

Zot Suprem, i Cili nuk ka as grua e as familje. Sipas Schmidt, këtë formë të besimit e hasim tek pigmenjtë e Afrikës qendrore, aborigjenët e Australisë jug-lindore, autoktonët amerikanë të Kalifornisë veri-qendrore, dhe deri diku edhe te algonkianët primitivë (grupe indianësh të Amerikës veriore që fillimisht kishin jetuar në regjionin nën-arktik të Kanadasë lindore - sh.p.), si dhe, deri në njëfarë mase, tek korjakët (grupe të nomadëve paleo-siberianë që jetonin kryesisht në Siberinë lindore - sh.p.) e tek ainutë (autoktonët e Hokaidos dhe pjesës veriore të Honshus në Japoninë veriore - sh.p.). Për të dhënë një përmbledhje të zbulimeve të tij, po ia lëmë vendin fjalëve të vetë autorit:

“Nëse kthehemi në periudhën e njerëzve më primitivë, periudhën e pigmenjve të Afrikës, aborigjenëve të Australisë qendrore apo indianëve të Amerikës qendrore, të gjithë këta kishin Një Zot, të cilit i ofronin sakrificat e tyre... të gjithë këta njerëz kishin edhe ca lutje të shkurtra...”¹⁹

Andrew Lang përmend këtë:

“Aborigjenët australianë, me gjasë, kanë kulturën më të thjeshtë nga të gjithë popujt e njohur, por konceptet e tyre religjioze janë aq të larta, sa është e natyrshme që ato të shpjegohen si rezultat i ndikimit evropian.”²⁰

Në kohën e shkrimeve të tij, Lang mendonte se ky shpjegim ishte i justifikueshëm, sepse, në mjedisin ku ai jetonte, koncepti rreth Zotit llogaritej si më i “evoluar” dhe më i “civilizuar”.

Lang, po ashtu, përmend se banorët e Ishujve Andaman, të cilët i konsideronte të jenë në nivel të njëjtë kulturor me aborigjenët, besonin në Një Zot dhe e përshkruanin Atë të jetë i padukshëm, i Pavdekshëm, Krijuesi i të gjitha gjërave (pos të ligës), Njohësi i zemrave dhe mendjeve, Ai që hidhërohet nga gënjeshtria dhe keqbërjet, që u del në ndihmë atyre që janë në fatkeqësi dhe vuajtje. Veç kësaj, koncepti i tyre rreth Zotit ishte se Ai është Gjykues i shpirtrave, dhe në një të ardhme do të udhëheqë Gjykimin e Madh. Lang këto të dhëna i kishte marrë nga anëtarët e moshuar të komunitetit të cilët nuk kishin pasur kontakt me popujt tjerë. Lang thotë:

“... Në konceptin e tyre rreth Zotit, as që bëhet fjalë për ndonjë ndikim të huaj.”²¹

Samuel Zwemer kishte diskutuar rreth karakterit monoteistë të bushmenëve dhe popujve të kulturave arktike. Ai kishte vërejtur se ky karakter është:

¹⁹ Wilhelm Schmidt “The Origin and Growth of Religion- Facts and Theories” (Zanafilla dhe zhvillimi i religjionit - fakte dhe teori), (Londër: 1931), fq.131. (përktheu HJ Rose).

²⁰ Andrew Lang “The Making of Religion” (Bërja e religjionit), (Londër: Longmans Green, 1909) fq.175-182, 196.

²¹ Ibid, fq.196.

“I qartë... madje, edhe në rastin e një hulumtimi të përciptë.”²²

Në punimin e tij, ky autor nuk përsëriste thjesht atë çfarë të tjerët kishin vërejtur, që d.t.th. njohuritë e këtyre popujve primitivë rreth Zotit, Një dhe më i Larti, por atë se Zoti më i Lartë, të cilin ata e njihnin, është, para se gjithash, figura e njëjtë dhe me attribute të njëjta.

Canon Titcombe, kur flet për fisin zullu, citon ish-peshkopin e Natalit, që posedonte njohuri nga dora e parë për këtë fis. Zullu, përderisa ende ishin të pandikuar në aspektin kulturor, nuk kishin idhuj, por e pranonin Një Qenie Supreme, që njihej si i Madhi, i Plotfuqishmi, i Pari, etj.²³ Titcombe pohon se ky koncept vërehet edhe tek banorët autoktonë të Madagaskarit.²⁴

Të gjitha këto dëshmi e shtyn Paul Radin të konstatonte, pasi përmend punimin e Langut, se:

“Mprehtësia e tij intuitive është provuar në masë të madhe.”²⁵

Për më tepër, “The Journal of the Royal Anthropological Institute” (Buletini i Institutit Antropologjik Mbretëror) publikoi një punim të E.O. James, i cili sjell këtë konkluzion:

“Prandaj, nuk është e mundur ta mbrojmë evolucionin e njëanshëm në mendimin dhe praktikën religjioze, siç është propozuar deri më tani nga racionalistët Frazer, Tylor dhe Comte në ‘Tri Etapat’. Sidoqoftë, as spekulimi se ideja e Zotit zuri fill tek adhurimet e paraardhësve - ide e ngjallur nga Herbert Spencer - e as modeli evolutiv i politeizmit dhe ai i animizmit në monoteizëm i propozuar nga Frazer, nuk mund të bashkërenditen me Zotin fisnor, që është Një dhe më i Larti, tipar ky i shpeshtë dhe i përsëritur në konceptin primitiv mbi Zotin.”²⁶

Degjenerimi i monoteizmit mund të shihet në Budizëm, që filloi në shekullin e 6-të si një lëvizje reformatore brenda Hinduizmit. Më vonë, statujat gjigante të imazheve të Budës u ngritën dhe u rrethuan me lule, me aromë dhe me tym temjani, etj. Budistët kryenin një numër ritesh, siç janë përkulja dhe rënia me fytyrë përdhe pranë këtyre statujave. Veç kësaj, Dalai Lama nga Tibeti adhurohet si zot-njeri nga adhuruesit e tij, të cilët bien përmbys para tij. Këto rite janë të pranishme edhe tek lëvizja botërore e sufive

²² Samuel Zwemer “The Origin of Religion - By Evolution or by Revelation” (Origjina e religjionit - përmes Evolucionit apo përmes Shpalljes), (Përkth. Vict. Institute, Vëllimi 67; 1937) fq.189.

²³ J.H. Titcombe “Prehistoric Monotheism” (Monoteizmi parahistorik), (Përkth. Vict. Institute, Vëll. 8, 1937) fq.145.

²⁴ Ibid, fq., 144.

²⁵ Paul Radin “Primitive Men as Philosophers” (Njerëzit primitiv si filozofë), (New York: 1956) fq.346.

²⁶ E.O. James “Religion and Reality” (Religjioni dhe realiteti) në “The Journal of the Royal Anthropological Institute” (Buletini i Institutit Antropologjik Mbretëror), (Vëll. 79, 1950) fq. 28.

nakshibendi, me liderin e tyre aktual Nazim Kubrusin. Pastaj tek “bërësit e mrekullive”, siç janë Sai Baba dhe “Ajetollah” Homeini. Të gjithë këta njerëz adhurohen krahas Allahut, gjë që argumenton edhe njëherë degjenerimin e monoteizmit në politeizëm.

Përktheu nga anglishtja: Visar ZEKA